



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 11, 12, par. 12.2, pika c) dhe 17, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 15 para. 1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna si dhe neneve 9 dhe 20 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 30. 05. 2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË
NË KOMUNË 2019-2023

Neni 1

MIRATOHET, Plani i Veprimit për transparencë në Komunën e Lipjanit për perioden 4 (katërvjeqare) 2019-2023.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i Veprimit për transparencë në Komunë 2019-2023.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Administratë.

Neni 4

1. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për miratimin e planit të veprimit për transparencë në Komunë, 15Nr.016-20221 i datës 30.03.2018.

15Nr.030-36024

Lipjan, më 31. 05. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

